



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2325 prot.

Shkodër, më 14.07.2022

V E N D I M

Nr. 142, datë 14.07.2022

"Për miratimin e Rregullores së Funksionimit të Klinikës së Fizioterapisë"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 38, pika 1, germa d; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa r, me propozim të Shkencave të Natyrës, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 14.07.2022

Vendosi:

1. Të miratojë Rregulloren për Funksionimin e Klinikës së Fizioterapisë në USH, bashkëlidhur.
2. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.





**UNIVERSITETI I SHKODRËS
“LUIGJ GURAKUQI”
KLINIKA E FIZIOTERAPISË**

**RREGULLORE E FUNKSIONIMIT TË
KLNIKËS SË FIZIOTERAPISË**

SHKODËR, 2022



PËRMBAJTJA

SHKODËR, 2022

PËRMBAJTJA

| | |
|---|------------------------------|
| Kuadri ligjor..... | Error! Bookmark not defined. |
| Objektivat e rregullores | Error! Bookmark not defined. |
| Detyrat e klinikës | Error! Bookmark not defined. |
| Organizimi dhe aktiviteti i klinikës..... | Error! Bookmark not defined. |
| Drejtuesi i klinikës | Error! Bookmark not defined. |
| Specialistët dhe personeli ndihmës..... | Error! Bookmark not defined. |
| Studentët..... | Error! Bookmark not defined. |
| Funksionimi dhe menaxhimi i klinikës | Error! Bookmark not defined. |
| Ekonomisti i klinikës | Error! Bookmark not defined. |
| Përkujdesja për pajisjet dhe instrumentet | Error! Bookmark not defined. |
| Ambientet e klinikës | Error! Bookmark not defined. |
| Puna në terren..... | Error! Bookmark not defined. |
| Orari i aktivitetit të klinikës | Error! Bookmark not defined. |
| Funksionimi i klinikës | Error! Bookmark not defined. |
| Dispozita të veçanta | Error! Bookmark not defined. |
| LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE | 9 |
| PAJISJET E KLINIKËS SË FIZIOTERAPISË | 11 |
| KARTELA E KLINIKËS SË FIZIOTERAPISË | 112 |



Neni 1 Kuadri ligjor

Rregullorja e funksionimit të Klinikës së Fizioterapisë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” bazohet në:

- Ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 3, pika 1, pika 3, germat a, b, c; Neni 95, pika 5; nenii 109, pika 1, germa c, ç, si dhe pikat 2 dhe 3;
- Statutin e Universitetit të Shkodrës.

Sipas Ligjit Nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në institucionet e arsimit të lartë, të ardhurat e realizuara nga shërbimet do të shpërndahen sipas meritës në Departamentet që ofrojnë këto shërbime.

Bazuar në nenin 109, pika 2 dhe 3 të ligjit të arsimit të lartë: “Të ardhurat e përfituar nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik ndahet ndërmjet personelit akademik dhe IAL-së, sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Administrimit”.

Neni 2 Objektivat e rregullores

Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e:

- a. Organizimit dhe aktivitetit të klinikës;
- b. Zgjedhjes së drejtuesve dhe detyrat e tyre;
- c. Angazhimit të studentëve dhe organizimin e mësimdhënies;
- d. Bashkëpunimit me klinika apo organizata të tjera;
- e. Kujdesit për bazën materiale;
- f. Mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave.

Neni 3 Detyrat e klinikës

- a. Klinika e Fizioterapisë pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka statusin e klinikës universitare dhe shërben për realizimin e procedurave të ndryshme fizioterapike, rehabilituese dhe mjekësore;
- b. Klinika përvëç funksionit didaktik për përgatitjen e studentëve, shërben edhe si njësi shërbimi ndaj të tjerëve;
- c. Klinika është e hapur ndaj të gjithë stafit akademik të Fakultetit për realizimin e punëve shkencore që janë në përputhje të plotë me legjisacionin;

- VERSIJA 2019*
- d. Klinika ofron shërbime fizioterapie dhe kërkim shkencor nga profesionistë të fushës së fizioterapisë, të cilët janë të pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit si "fizioterapeut" që janë staf akademik apo ndihmës akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Neni 4 Organizimi dhe aktiviteti i klinikës

- a. Klinika e fizioterapisë është njësi pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, që ofron edukim praktik dhe klinik për studentët, shërbime ndaj të tretëve, kërkim shkencor si dhe edukim të vazhduar për personelin shëndetësor;
- b. Organizimi dhe shpërndarja e punës në klinikë bëhet nga Drejtuesi i klinikës;
- c. Rastet në klinikë konsiderohen jo vetëm si element didaktik për formimin praktik dhe klinik të studentëve, por edhe si burim të ardhurash;
- d. Personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët në çdo situatë janë të kushtëzuar të shfaqin një paraqitje dinjitoze në sjellje, veshje, komunikim dhe të respektojë kodin etik dhe deontologjik.

Neni 5 Drejtuesi i klinikës

- a. Drejtuesi i klinikës propozohet nga departamenti dhe nga fakulteti përkatës dhe miratohet nga Rektori i USH-së;
- b. Drejtuesi i klinikës është personel me kohë të plotë pranë departamentit përkatës dhe ka minimumi 5 vjet punë;
- c. Drejtuesi i klinikës duhet të ketë domosdoshmërisht lejen e ushtrimit të profesionit "fizioterapeut";
- d. Drejtuesi i klinikës preferohet të ketë gradë dhe tituj akademikë në fushën e fizioterapisë;
- e. Drejtuesi i klinikës duhet të jetë një person që ka aftësi të mira organizative, profesionale dhe të punojë në grup.

Neni 6 Specialistët dhe personeli ndihmës

- a. Specialistët/personeli akademik dhe ndihmës akademik, punojnë në bashkëpunim të ngushtë me njëri-tjetrin në ofrimin e shërbimit, por edhe në realizimin e praktikës mësimore me studentët;
- b. Në çdo rast, gjatë realizimit të trajtimit, duhet të këtë diskutime mes specialistëve dhe bashkëpunim mes tyre për zgjidhjen në mënyrën sa më të mirë të mundshme të rasteve klinike që paraqiten në klinikë;
- c. Etikë e lartë, respektimi i hierarkisë dhe komunikimi dinjitoz, duhen të jenë kushte parësore;

- 
- d. Në funksion të klinikës shërben edhe një sanitar/e e institucionit i/e cili/a ka si detyrë mbajtjen në nivel të lartë të higjienës së klinikës;
 - e. Staf akademik duhet vazhdimesht të kontrollojë dhe të plotësojë materialet e konsumit që përdoren gjatë seancave të trajimit dhe orëve të mësimit, si dhe të kontrollojë sasinë e materialeve dhe datën e skadimit të tyre në mënyrë që ato të ripërtërihen dhe plotësohen në kohë;
 - f. Në rast se ka nevojë për materiale ose pajisje shtesë, stafi akademik dhe ai teknik që punon me studentët, duhet të informojnë drejtuesin e klinikës në mënyrë që këto mungesa të plotësohen në kohë.

Neni 7 **Studentët**

- a. Studentët zhvillojnë në klinikë praktika mësimore në lëndët mësimore sipas kurrikulës së programit të studimit që ofron programet e studimit Fizioterapi, Infermieri, Mami, Edukim Fizik etj. Në klinikë nuk lejohet qëndrimi i studentëve të pashoqëruar nga stafi akademik dhe pa uniformë;
- b. Aktiviteti i studentëve në realizimin e praktikës profesionale në klinikë përcaktohet në fillim të çdo viti akademik për orët, temat dhe ndjekësit e praktikave;
- c. Studentët duhen inkurajuar të jenë pjesëmarrës sa më shumë të jetë e mundur në çdo aktivitet të klinikës, gjithnjë nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e personelit akademik;
- d. Klinika do t'u shërbejë studentëve përritjen e tyre profesionale dhe vlerësimin e tyre;
- e. Sjelljet e studentëve, komunikimet me njëri-tjetrin, me pacientët dhe me stafin akademik duhen të jenë korrekte. Paraqitja e jashtme e tyre duhet të jetë dinjitoze, ata duhet të jenë të veshur detyrimisht me uniformë.

Neni 8 **Ekonomisti i klinikës**

- a. Ekonomisti i klinikës është ekonomist i punësuar pranë USH-së dhe ndjek veprimtarinë ekonomike të klinikës së fizioterapisë;
- b. Ekonomisti i klinikës caktohet nga Rektori i USH-së;
- c. Çdo veprimtari ekonomike e klinikës auditohet nga zyra e auditit të USH-së, një herë në vit;
- d. Kujdeset për mbajtjen e kontabilitetit financiar të klinikës në përputhje me legjisacionin tativor në fuqi;
- e. Kujdeset për përgatitjen e dokumenteve për evidentimin dhe ndjekjen e shpenzimeve;
- f. Është përgjegjës për përgatitjen e informacionit financiar të përshtatshëm si dhe regjistrimin e të dhënavë financiare të aktivitetit financiar të klinikës së Fizioterapisë, në sistemin kontabël të institucionit;
- g. Shpërndan kompensimet për punonjësit që ofrojnë shërbimet e trajimit mjekësor fizioterapeutik në klinikë, sipas rasteve dhe përqindjeve të përcaktuara në këtë rregullore;
- h. Regjistron depozitat dhe pagesat bankare;

- i. Përgatit e përpilon situacionet e raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Neni 9
Funksionimi dhe menaxhimi i klinikës

- a. Klinika e Fizioterapisë ushtron veprimtarinë ekonomike në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- b. Inventari i materialeve të konsumit, hyrje-daljet e tyre, të ardhurat, procedurat tatile dhe fiskale, raportet financiare, ndarja e bonuseve finaciare etj., kryhen nga ekonomisti i klinikës, i cili vë në dijeni Drejtuesin e klinikës për çdo veprim;
- c. Drejtuesi i klinikës përkujdeset që punët e përditshme të klinikës të funksionojnë siç duhet, duke i lejuar personelit akademik të jetë i fokusuar vetëm tek puna rehabilituese me pacientët dhe asaj akademike me studentët;
- d. Personeli akademik dhe ndihmës akademik përfshihen në realizimin e procedurave mjekësore, mbështetur në shtojcat e kësaj rregulloreje;
- e. Duke u refuar në shtojcat aneks të listës së çmimeve të shërbimeve të kësaj rregulloreje:
 - 50% e të ardhurave nga kryerja e çdo shërbimi ndaj pacientëve i kalojnë personelit akademik të përfshirë në zgjidhjen e rastit;
 - 25% përdoren për blerjen e materialeve të konsumit në bazë të listës që përpilohet nga drejtuesi dhe ekonomisti i klinikës, riparimin e pajisjeve kur është e mundur dhe blerjet e pajisjeve/mjeteve të reja përmodernizimin e herëpashershëm të klinikës;
 - 25 % kalojnë në llogarinë e USH-së.
- f. Personeli i punësuar në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" përfiton 50 % zbritje nga pagesa e referuar në listën e çmimeve të miratuara;
- g. Ekonomisti i klinikës mbi bazën e të ardhurave të klinikës në zbatim të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi, sa herë që është e nevojshme, sipas porosive dhe kërkesave të specialistëve, me miratim të Drejtuesit të klinikës duhet të sigurojë blerjen e materialeve të konsumit, të cilat janë në funksion të punës së përditshme të klinikës, duke mos krijuar mungesa në funksionimin e klinikës.

Neni 10
Përkujdesja për pajisjet dhe instrumentet

- a. Personeli akademik që punon në klinikën e Fizioterapisë, duhet të tregojë kujdes përmirëmbajtjen e pajisjeve dhe instrumenteve që shërbejnë për trajtimet e ndryshme;
- b. Studentëve u lejohet të punojnë me pajisjet dhe mjetet e tjera teknike në pronësi të klinikës vetëm në prani dhe nën mbikëqyrjen e personelit akademik;
- c. Specialistët/stafi akademik duhet të raportojnë çdo trajtim të paautorizuar të pajisjeve, si dhe dëmtimet në pajisje;
- d. Specialistët/stafi akademik duhet të pastrojnë pajisjet siç duhet pas përdorimit dhe t'i ruajnë ato në hapësirën e ofruar në klinikë.



Neni 11 Ambientet e klinikës

Ambientet e klinikës së Fizioterapisë përbëhen nga:

- a. Salla e recepcionit me një ambient pritjeje për klientët, një kompjuter të pajisur me një database elektronik për regjistrimin e pacientëve, seancave, pagesave etj., dhe një kartotekë për ruajtjen e kartelave të trajtimit të pacientëve;
- b. Sallë për ushtrimet fizike;
- c. Sallë e ndarë në dhoma të vogla, ku secila ndarje ka një krevat të veçantë për trajtimin me terapi fizike (elektroterapi, tekarterapi, magnetoterapi, laserterapi, ultratingull etj.);
- d. Garderoba për studentët për veshjen e uniformave;
- e. Ambienti i jashtëm përreth kësaj godine;
- f. Në funksion të klinikës së Fizioterapisë në të ardhmen mund të jenë edhe klinika të tjera mjekësore apo laboratorike që mund të krijohen pranë fakultetit.

Neni 12 Puna në terren

- a. Përmes bashkëpunimit me organizata profesionale të fizioterapisë apo klinika të tjera të ngjashme, duhet të krijohet mundësia e ofrimit të shërbimit edhe në terren (shtëpi, institucione të ndryshme rezidenciale, spitale private etj.), për pacientët që nuk mund të aksesojnë klinikën;
- b. Çdo rast i shërbimit jashtë klinikës/terren pasqyrohet në database të klinikës, direkt pas shërbimit të ofruar;
- c. Personeli akademik mësimdhënës dhe personeli ndihmës akademik të cilët punojnë në terren marrin shpërblime të përcaktuara sipas kësaj rregulloreje.

Neni 13 Orari i aktivitetit të klinikës

- a. Orari i realizimit të aktivitetit në klinikë është 10:00 – 19:00, nga e hëna në të premte;
- b. Klinika e fizioterapisë brenda afatit 1 deri 3-vjeçar, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, synon arritjen e mbulimit me shërbime mjekësore 7 ditë të javës me dy turne.

Neni 14 Funksionimi i klinikës

- a. Pacientët që ekzaminohen apo trajtohen regjistrohen në librin e klinikës;
- b. Stafi akademik së bashku me stafin ndihmës duhet të orientojnë çdo rast drejt zgjedhjes optimale, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me njëri-tjetrin, mjekët specialistë dhe me klinika apo spitale të tjera;

- KOPI*
- c. Pacienti paraqitet në klinikë me rekomandimin e mjekut për të zhvilluar seanca të fizioterapisë;
 - d. Stafi akademik që ndjek rastin në klinikë e regjistron pacientin duke i hapur kartelën e fizioterapisë (sipas modelit bashkëlidhur);
 - e. Kartela e fizioterapisë është pronë e klinikës dhe e pacientit. Kopja originale ruhet në kartotekën e klinikës, ndërsa fotokopja mund t'i jepet pacientit në rast nevoje;
 - f. Kartela shërben dhe si mjet didaktik për studentët gjatë praktikës profesionale;
 - g. Pas vizitës së parë në klinikë, pacientit i bëhet e qartë përvëç problemeve lidhur me patologjinë e tij, edhe numri i seancave që duhet të ndjekë, kostoja financiare e tyre dhe mënyra e pagesës;
 - h. Çdo punë e kryer në klinikë duhet të pasqyrohet e saktë dhe e detajuar në një regjistër tip që tregon edhe pagesën e klientit. Regjistri të firmoset në fund të ditës nga personi që kryen shërbimin dhe në fund të çdo muaji të kundërfirmoset nga Drejtuesi i klinikës;
 - i. Të gjitha të dhënat e përfituarë në klinikë, mjekimet, fotografitë etj., janë pronë ekskluzive e Universitetit dhe duhet të respektojnë legjislacionin në fushën e mbrojtjes së të dhënavë personale;
 - j. Pastërtia në ambientet e klinikës duhet të jetë shembullore;
 - k. Stafi i klinikës kujdeset për shëndetin e patienteve të klinikës së fizioterapisë;
 - l. Stafi akademik i përfshirë në punët e klinikës, me praninë edhe të studentëve të interesuar, organizojnë në klinikë konsultat e mëngjesit të rasteve të paraqitura;
 - m. Rastet atipike interesante prezantohen dhe diskutohen edhe në nivel departamenti.

Neni 15 Dispozita të veçanta

1. Kjo “*Rregullore*” e shtrin veprimtarinë e saj duke filluar nga viti akademik 2021 - 2022.
2. Shpenzimet për licencimin apo procedura të tjera fillestare të fillimit të funksionimit të klinikës mbulohen nga USH.

Neni 16

1. Të drejtën e patjetërsueshme për interpretimin e kësaj *Rregulloreje* e ka Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit i Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”.
2. Ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të Drejtuesit të klinikës ose të departamentit përkatës dhe miratohen paraprakisht në dekanati. Ndryshimet përcillen për miratim në Senatin Akademik nga Dekani i fakultetit.

Miratuar me vendim nr. ___, datë ___ / ___ / _____. të Senatit Akademik të Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”.

Miratuar me vendim nr. ___, datë ___ / ___ / _____. të Bordit të Administrimit të Universitetit të Shkodrës “*Luigj Gurakuqi*”.

V. O.: Bashkëngjitur: Pajisjet dhe lista e çmimeve të shërbimeve.



SHTOJCA
KLINKA E FIZIOTERAPISË
LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

| Nr | Patologjia | Çmimi në lekë për seancë |
|----|--|--------------------------|
| | Patologji ortopedike Traumatologjite sportive | |
| 1 | Dëmtimet e meniskut dhe ligameteve, | 1500 Lekë |
| 2 | Borsitet, | 1500 Lekë |
| 3 | Distorsion (ndrydhje), | 1500 Lekë |
| 4 | Tendinitet, | 1500 Lekë |
| 5 | Post frakturnat, | 1500 Lekë |
| 6 | Artrozat (koksartoza, gonartroza, spondiloartroza), | 1500 Lekë |
| 7 | Elongacione ose strap muskulare. | 1500 Lekë |
| | Patologji te kolonës vertebrale | |
| 1 | Cervikal gjji (dhimbjet e qafës), | 1500 Lekë |
| 2 | Lombalgji (dhimbjet e mesit), | 1500 Lekë |
| 3 | Hernie diskut vertebral, | 1500 Lekë |
| 4 | Dëmtimet e nervit shiatik, | 1500 Lekë |
| 5 | Sidroma e tunel carpal, | 1500 Lekë |
| 6 | Skolioza, | 1500 Lekë |
| 7 | Hiperlordoza, kifoza. | 1500 Lekë |
| | Patologjite neurologjike | |
| 1 | Hemiplegji, | 1500 Lekë |
| 2 | Paraliza faciale dhe paraliza te ndryshme, | 1500 Lekë |
| 3 | Dëmtimet e nervave periferike, | 1500 Lekë |
| 4 | Parkinson, | 1500 Lekë |
| 5 | Sklerozë multiple, | 1500 Lekë |
| 6 | Skleroza Laterale Amiotrofike, | 1500 Lekë |
| 7 | Patologjite e medulës spinale. | 1500 Lekë |
| | Patologjite reumatologjike | |
| 1 | Artrit reumatoïd, | 1500 Lekë |
| 2 | Spondiloarrit, | 1500 Lekë |
| 3 | Osteoartit, | 1500 Lekë |
| 4 | Osteofite. | 1500 Lekë |
| | Rehabilitim post operator | |
| 1 | Artroproteza totale/parciale, | 1500 Lekë |
| 2 | Patologjite e Meniskut, | 1500 Lekë |
| 3 | Patologjite e Legamenteve. | 1500 Lekë |
| | Rehabilitim kardiorespirator | |
| 1 | Rehabilitim post Covid – 19, | 1500 Lekë |
| 2 | Reabilitimi respirator në pacientët me BPCO, | 1500 Lekë |
| 3 | Reabilitimi i pacientëve me enfizeme, | 1500 Lekë |

| | | |
|----------|--|-----------|
| 4 | Fizioterapi pas ndërhyrjes kardio-kirurgjikale. | 1500 Lekë |
| | Rehabilitim pediatrik | |
| 1 | Paraliza cerebrale infantile, | 1500 Lekë |
| 2 | Piede torte congenita, | 1500 Lekë |
| 3 | Dëmtimet e kolonës vertebrale në moshë pediatrike, | 1500 Lekë |
| 4 | Patologji pediatrike neuromuskolare, | 1500 Lekë |
| 5 | Lezion i pleksit nervore brakial. | 1500 Lekë |
| | Patologji të tjera | |
| 1 | Patologji të tjera. | 1500 Lekë |

PAJISJET E KLINKËS SË FIZIOTERAPISË

Pjesët përbërëse të laboratorit janë aparaturat e mëposhtme:

| Nr | PAJISJE |
|----|--|
| 1 | Tekar Terapi, |
| 2 | Magnetoterapi (Mag 2000 + Osteomat 2000 krevat trajtimi për magnetoterapi), |
| 3 | Krevat trajtimi hidraulik - me 5 seksione, |
| 4 | Pajisje Ultratingulli (Ultrasound Device), |
| 5 | Elektrostimulues Tens (Electroestimulues Tens), |
| 6 | Elektrostimulues Tens + Ems Professional, |
| 7 | Aparat Laser, |
| 8 | Llampe Infra të Kuqe (Infra-Red Lamp), |
| 9 | Pajisje për rehabilitimin e krahut (Nautical Wheel), |
| 10 | Paralele të rregullueshme me lartësi (Hight Adjustable Parallels), |
| 11 | Pajisje për traksion cervical, |
| 12 | Ndihmës për ecje (Walker Aid), |
| 13 | Topa bobat për ushtrime të ndryshme, |
| 14 | Biçikletë statike (Static Bicycle), |
| 15 | Karrocë manuale me rrata për të sëmurë, |
| 16 | Tapet për realizimin e ushtrimeve, |
| 17 | Pasqyrë me kuadrate (Mirror Quadrats), |
| 18 | Aparat tensioni, |
| 19 | Goniometër, |
| 20 | Paterica kanadeze me mbështetje në parakrah, |
| 21 | Paterica kanadeze me mbështetje tek sqetullat, |
| 22 | Jastekë ortopedikë pozicionimi, |
| 23 | Balance Board/Jastek Propioceptiv për përmirësimin e ekuilibrit, |
| 24 | Pedanë për ekuilibrin Freeman, |
| 25 | Pesha stërvitje, |
| 26 | Aparaturë Shock Wave Therapy, |
| 27 | Krevat profesional traksioni i shtyllës kurriore, |
| 28 | Krevat profesional bobat për trajtim, |
| 29 | Stabilizues vertikal (mbajtës i pusturës drejt në këmbë), |
| 30 | Pistë ecjeje dhe vrapimi, |
| 31 | Aparaturë për presion terapinë , |
| 32 | Aparatura Holter ECG për matjen e ritmit kardiak, matjen e presionit arterial. |